



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Shkup, 29 nëntor 2024

Njoftim për shtyp

Lëvizjet më të rëndësishme të normat e interesit të bankave dhe kursimoreve¹: tetor 2024

- Në tetor 2024, norma mesatare e interesit të totalit të kredive shënon 5,38% dhe është ulur në baza mujore dhe vjetore për 0,03 p.p. dhe respektivisht, 0,11 p.p. Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave shënoi rritje mujore dhe vjetore prej 0,06 p.p. dhe përkatësisht 0,40 p.p. dhe arrin 2,07%.
- Norma mesatare e interesit të kredive të reja² në tetor arrin 4,81% dhe shënon rënie mujore dhe vjetore prej 0,17 p.p. dhe respektivisht 0,74 p.p. Norma mesatare e interesit të depozitave të reja shënoi rritje mujore dhe vjetore prej 0,24 p.p. dhe 0,64% p.p., respektivisht dhe arrin 2,84%.

Tabela 1. Normat e interesit të totalit dhe kredive dhe depozitave të reja

	10.2023	11.2023	12.2023	1.2024	2.2024	3.2024	4.2024	5.2024	6.2024	7.2024	8.2024	9.2024	10.2024
në % në bazë mujore													
Totali i kredive	5.49	5.48	5.47	5.55	5.52	5.50	5.51	5.49	5.47	5.46	5.44	5.41	5.38
Korporatat	5.37	5.36	5.33	5.44	5.40	5.65	5.35	5.31	5.26	5.23	5.20	5.15	5.09
Amviseritë	5.60	5.59	5.59	5.65	5.64	5.35	5.65	5.65	5.66	5.67	5.66	5.66	5.66
Kreditë e reja	5.55	5.38	5.21	5.22	5.35	4.98	5.47	5.19	5.08	5.12	5.04	4.98	4.81
Korporatat	5.71	5.39	5.30	5.21	5.25	5.40	5.57	5.16	4.95	4.96	4.90	4.78	4.65
Amviseritë	5.28	5.35	5.02	5.26	5.45	4.73	5.33	5.26	5.29	5.34	5.28	5.27	5.17
Depozitat	1.67	1.74	1.79	1.72	1.76	1.80	1.82	1.86	1.88	1.93	1.96	2.01	2.07
Korporatat	1.96	2.23	2.06	2.07	2.08	1.76	2.11	2.21	2.25	2.28	2.20	2.34	2.42
Amviseritë	1.64	1.69	1.76	1.69	1.73	2.12	1.79	1.81	1.84	1.89	1.93	1.97	2.02
Depozitat e reja	2.32	2.28	2.37	2.22	2.31	2.46	2.54	2.36	2.52	2.76	2.43	2.60	2.84
Korporatat	1.51	1.71	2.19	2.02	2.19	2.42	2.61	2.38	2.39	3.03	1.99	2.14	2.75
Amviseritë	2.57	2.46	2.42	2.30	2.35	2.52	2.52	2.36	2.55	2.68	2.76	2.79	2.89

Burimi: BPRMV-ja.

¹ Me termin "normë interesi" nënkuptohet normë e ponderuar mesatare e interesit e shprehur në përqindje në bazë vjetore. Për shpjegim më të hollësishëm shihni Metodologjinë http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologjia/Metodologjia_MIR_07_2018_mak.pdf



² Lidhur me normata e interesit të kredive të reja / depozitat e reja janë karakteristike zhvillime të ndryshueshme. Lëvizjet e tilla të normave të interesit janë si rezultat i ndryshimeve në vëllimin e depozitave/kredive të reja (të cilat nga muaji në muaj mund të ndryshojnë konsiderueshëm), si dhe nga norma e rënë dakord rishtazi e interesit.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



1. Norma të interesit në sektorin korporativ³

- Në tetor, norma mesatare e interesit e totalit të kredive të sektorit korporativ është 5,09% dhe është ulur për 0,06 p.p. në bazë mujore. Analizuar sipas valutës, ndryshimi është rezultat i rënies së interesit në të gjithë komponentët: normat e interesit të kredive në denarë me klauzolë valutore (për 0,15 p.p.), normat e interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,10) dhe normat e interesit të kredive në denarë pa klauzolë valutore (për 0,03 p.p.). Krahasuar në bazë vjetore, norma e interesit e totalit të kredive të sektorit korporativ është ulur për 0,28 p.p.



Burimi: BPRMV-ja.

- Këtë muaj, norma e interesit për kreditë e sapomiratuara për sektorin korporativ arrin 4,65% dhe shënon rënie mujore prej 0,13 p.p. Njëkohësisht, ndryshimi në rënie është rezultat i rënies së normave të interesit të kredive në denarë pa dhe me klauzolë valutore (për 0,27 p.p. dhe për 0,12 p.p., respektivisht), ndërsa normat e interesit të kredive në valutë të huaj shënojnë rritje (për 0,21 p.p.). Në krahasim me tetorin e vitit të kaluar, kjo normë e interesit është ulur për 1,06 p.p.



Burimi: BPRMV-ja.


³ Për nevojat e këtij njoftimi, sektori korporativ përfshin institucionet jo-financiare (publike dhe të tjera).




Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

- Norma mesatare e interesit të totalit të depozitave të sektorit korporativ, në tetor, është më e lartë për 0,08 p.p. dhe është 2,42%. Ndryshimi rezulton nga rritja e të gjithë komponentëve, përkatësisht: normat e interesit të depozitave në denarë me dhe pa klauzolë valutore (për 0,27 p.p. dhe 0,09 p.p., përkatësisht) dhe të normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,01 p.p.). Norma e interesit të totalit të depozitave të reja të sektorit korporativ është rritur për 0,46 p.p. në bazë vjetore.
- Në tetor, norma e interesit për depozitat e sapo pranuar⁴ të sektorit korporativ është 2,75% dhe shënoi rritje mujore prej 0,61 p.p. Rritja vjetore shpjegohet me rritjen e normave të interesit të kredive në denarë me dhe pa klauzolë valutore (për 0,60 p.p. dhe 0,53 p.p., përkatësisht) dhe normat e interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,36 p.p.). Në bazë vjetore, kjo normë e interesit shënon rritje prej 1,24 p.p.

2. Norma të interesit për amvisëritë⁵



Burimi: BPRMV-ja.




- Norma e interesit e totalit të kredive për amvisëritë, këtë muaj është e pandryshuar në bazë mujore dhe shënon 5,66%. Rritja vjetore e normës së interesit arrin 0,06 p.p.
- Në tetor, norma mesatare e interesit për kreditë e sapomiratuara për amvisëritë është 5,17% dhe në nivel mujor është më e ulët për 0,10 p.p. Rënia është rezultat i rënies së normave të interesit të kredive në denarë me dhe pa klauzolë valutore (për 0,06 p.p, përkatësisht 0,03 p.p.) në kushte të rritjes së normave të interesit të kredive në valutë të huaj (për 0,32 p.p.). Norma mesatare e interesit të kredive të sapo miratuara për amvisëritë është më e ulët për 0,11 p.p. krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

⁴ Në grafikun që i referohet normave të interesit për depozitat e reja të sektorit korporativ, ndërprerja në seritë e të dhënave të normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është si rezultat i asaj që në muaj të caktuar bankat dhe kursimoret nuk kanë pranuar lloj të atillë të depozitave nga sektori korporativ.

⁵Për nevojat e këtij njoftimi, amvisëritë përfshijnë: persona fizik, ekzekutues të pavarur të veprimtarisë dhe institucione jofitimprurëse të cilët u shërbejnë amvisërive.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë



Burimi: BPRMV-ja.

- Këtë muaj, norma e interesit e totalit të depozitave për amvisëritë është 2,02%, që paraqet rritje mujore prej 0,05 p.p. Ndryshimi në rritje vjen si pasojë e rritjes së normave të interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore dhe të normave të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,05 p.p., respektivisht 0,04 p.p.), me rënie të normave të interesit të depozitave në denarë me klauzolë valutore (për 0,09 p.p.). Krahasuar në bazë vjetore, kjo normë e interesit është rritur për 0,38 p.p.
- Në tetor norma e interesit të depozitave të sapo pranuar të amvisërive⁶ është 2,89% duke shënuar një rritje mujore prej 0,10 p.p. Rritja vjen si pasojë e normave më të larta të interesit të depozitave në valutë të huaj (për 0,14 p.p.) dhe normat e interesit të depozitave në denarë pa klauzolë valutore (për 0,05 p.p.). Njëkohësisht, këtë muaj bankat dhe kursimoret nuk kanë regjistruar depozita të sapo pranuar në denarë me klauzolë valutore. Analizuar në bazë vjetore, norma e interesit e depozitave të sapo pranuar për amvisëritë është më e lartë për 0,32 p.p.

⁶ Në grafikun që u referohet normave të interesit të depozitave të reja të amvisërive, ndërprerja e serive e të dhënave në normat e interesit në denarë me klauzolë valutore është për shkak të faktit që në muaj të caktuar bankat dhe shtëpitë e kursimit nuk kanë pranuar depozita të amvisërive të këtij lloji.



Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut Drejtoria për Statistikë

Informacione mbështetëse

Seri kohore të të dhënave: të dhëna vjetore, tremujore dhe mujore për normat e ponderuara të interesit të bankave dhe kursimoreve

https://www.nbrm.mk/statistika_na_kamatni_stapki-al.nspix

Shpjegime metodologjike:

http://www.nbrm.mk/content/statistika/Monetarna%20statistika/metodologija/Metodologija_MIR_07_2018_mak.pdf

Publikimet e ardhshme: Kalendari i publikimit të të dhënave

https://www.nbrm.mk/content/statistika/kalendar/Kalendar_i_publicimit_t%C3%AB_t%C3%AB_dh%C3%ABnave.pdf

Të dhëna mujore për normat e interesit: 30 dhjetor 2024 (mesatare referuese, përfshirë nëntorin e vitit 2024).

Për pyetje të gazetarëve, Ju lutemi kontaktoni me personat nga Kabineti i Guvernatorit.

Për informacione më të hollësishme në lidhje me të dhënat e publikuara statistikore, na kontaktoni në: contact.statistika@nbrm.mk ose në numrin e telefonit lokal 02/3215-235, lok. 108/110.